



REPUBLIC OF KOSOVO  
KOSOVA  
SKUPŠTINA REPUBLIKË  
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO  
Zëra për Propozime dhe Propozime-Kandidime të Fardogës Presidenciale

No. Prop. 06/671 / 06-419  
Ref. Prop. / Ref. Prop. No.  
Data 07.02.2018  
En. / En. / En.  
Date / Date / Date

PRISTINE - PRISTINE

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Ministrin e Arsimit, Zot. Shiqeri Bytyqi</b>	<b>DATE DATUM</b>	<b>7.02.2018</b>
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD /</b>	<b>Arbërie Nagavci</b> <i>(Signature)</i> <b>Depute e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA: Zot. Ministër,**

Me dt. 15 nëntor 2017 MASHT kishte shpallur konkursin: "Shkencëtar i vitit 2017" dhe "Shkencëtari i ri i vitit 2017".

Sipas Konkursit, Ministria kishte krijuar një fond për çmime vjetore për rezultate të jashtëzakonshme hulumtuese-shkencore brenda një periudhe njëvjeçare (rezultatet shkencore nga shtatori 2016 deri në tetor 2017). Këto çmime synonin të promovojnë cilësinë në punën shkencore, të inkurajojnë ngritjen në karrierë dhe shpërblimin e përpjekjeve dhe përkushtimin e hulumtuesve shkencorë të cilët janë në proces të avancimit të diturive të tyre në fushën përkatëse të ekspertizës dhe ishte paraparë të ndahen 3 (tre) çmime për "Shkencëtarin e vitit" dhe 3 (tre) çmime për "Shkencëtarin e ri të vitit".

Sipas asaj që kemi kuptuar nga mediat dhe në bazë të deklaratave tuaja në Komisionin për Arsim kemi kuptuar se ky konkurs është anuluar me arsyetimin se Këshilli Shkencor i MASHT-it ka pasur tetë anëtarë e duhej të kishte shtatë, pra e cilësuar këtë si Joligjore.

**PYETJE PARLAMENTARE:**

**Zot. Ministër A mund të na tregoni se çfarë keni ndërmarrë në raport me këtë shkelje, pra me faktin se Komisioni ishte i jashtëligjshëm?**

**Kur ishte themeluar Këshilli Shkencor dhe nga kush është emëruar?**

**Si ndodhi që konkursi të hapej pa pasur parasysh kompetencat e organit që do të vlerësonte aplikacionet e shkencëtarëve të rinjë?**

**Kush mban përgjegjësi për këtë gabim i cili ka pasur pasoja edhe tek kandidatët të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs duke plotësuar edhe aplikacionet sipas kërkesave të konkursit dhe duke kërkuar në mjaft raste edhe nominim nga institucionet ndërkombëtare?**

**Poashtu ju lutem të na njoftoni se a do të rishpallet konkursi konform Ligjit nr.04/04L për Veprimtari Kërkimore-Shkencore. Nëse po, kur do të rishpallet ky konkurs dhe a do të merrni parasysh aplikacionet që kanë dorëzuar tashmë shkencëtarët e rinjë, apo duhet që ata të riaplikojnë?**

**Ju faleminderit,**